



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 7.10.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datës 16 shtator 2019 dhe 7 tetor 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për korporatën e investimeve shqiptare”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Reme Lala.

Për të prezantuar projektligjin në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm Z. Elton Haxhi Zv.Ministër i Financave dhe Ekonomisë si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, objektivat e synuara të propozimit dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit

Projektligji, ka për qëllim krijimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimit e veprimtarisë së saj.

Korporata e investimeve do të ketë kapacitetin për të transformuar ide dhe nisma investimesh në projekte të financueshme dhe tërheqjen e interesit nga investitorë cilësorë, duke përdorur më mirë dhe më me efektivitet e efikasitet, tokën dhe/ose asetet e tjera dhe të përgatisë projekte që nëse vlerësohen të përshtatshme, mund të financohen.

Sipas projektligjit, Korporata e Investimeve Shqiptare, vjen si një koncept inovator për të adresuar nevojën e zhvillimit të krijimit të kapaciteteve për lehtësimin dhe realizimin e investimeve komplekse dhe me impakt ekonomik.

Objektivat e projektligjit.

Objekti i veprimtarisë së Korporatës do të jetë përmirësimi i menaxhimit të pronës publike, krijimi i pronave të reja, vënia në përdorim më efikasitet të pronave, përgatitja dhe zbatimi i projekteve të investimit dhe mobilizimi i kapitalit shtetëror ose privat, me qëllim kryerjen e investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Objektivi kryesor i Korporatës sipas projektligji konsiston në:

- Nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor e rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit;
- Vënie në përdorim me efikasitet të pronave shtetërore;
- Kryerjen e investimeve, duke mobilizuar kapitalin shtetëror dhe/ose privat.

Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji i propozuar nga Këshilli I Ministrave është i ndarë në 6 krerë dhe 26 nene.

Kreu I, (nenet 1-5) përcakton qëllimin, objektin, parimet e përgjithshme, statusin juridik të korporatës, si dhe burimet financiare të saj.

Kreu II (nenet 6-10), trajton, objektin e veprimtarisë të Korporatës, liston në mënyrë të detajuar funksionet e saj, përcakton mënyrën e transferimit të pronave shtetërore, procedurat për dhënie autorizimeve si dhe format e pjesëmarrjes së Korporatës së Investimeve.

Kreu III (nenet 11-13), trajton, masat mbështetëse, konkretisht mbështetjen me infrastrukturën e brendshme, marrjen e licencave/lejeve/autorizimeve të nevojshme për realizimin e një

projekti, si dhe përcakton regjimin e prokurimit dhe/ose konkurrimit të cilët do të jenë të posaçme sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave për këtë qëllim.

Kreu IV (nenet 14-21) trajton, strukturën organizative të korporatës, organet drejtuese të saj, llojin e vendimeve që merr Asambleja e Përgjithshme, përbërjen dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, mënyrën e emërimit dhe kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv, përbërjen dhe natyrën e Bordit Këshillimor si dhe përcakton mënyrën e miratimit të strukturës dhe marrëdhënieve të punës së administratës (personelit) të Korporatës.

Kreu V (nenet 22-23), trajton kontabilitetin dhe auditimin e pasqyrave financiare.

Kreu VI (nenet 24-26), përbën edhe dispozitat e fundit të projektligjit ku trajtohen aktet nënligjore, dispozitat kalimtare si dhe hyrjen në fuqi të projektligjit.

IV. Efektet financiare të projektligjit

Miratimi i projektligjit do të shoqërohet me kosto financiare, pasi krijon strukturë të re shtetërore.

Për vitin 2019, nga buxheti i shtetit është parashikuar një fond buxhetor prej 368 milionë lekësh, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si kapital fillestar për Korporatën.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij u shpreh se Qeveria Shqiptare ndodhet përballë sfidës së përshpejtimit të rritjes ekonomike, e cila mund të arrihet përmes zgjerimit të kapacitetit të ekonomisë, për të identifikuar, përgatitur dhe ekzekutuar, projekte investimi me impakt të gjerë, që kërkojnë shfrytëzimin e aseteve shtetërore si dhe mobilizimin e kapitalit privat. Këto projekte investimi, nuk mund të realizohen nga sektori privat pa përfshirjen në një masë të konsiderueshme të shtetit në procesin e dhënies së autorizimit dhe vënies në dispozicion të aseteve.

Për të arritur pikërisht, qëllimin e rritjes ekonomike, është vlerësuar e nevojshme, krijimi i një institucioni të posaçëm, që të konceptualizojë projekte dhe të sigurojë kombinimin e duhur të aseteve shtetërore me investimet private.

Për ta mundësuar krijimin e këtij institucioni të posaçëm, është i domosdoshëm një kuadër ligjor i konsoliduar institucional. Relatori theksoi gjithashtu faktin se krijimi i institucioneve të tilla është një eksperiencë e ndjekur edhe nga vende të tjera.

Për sa më sipër, Ministria e Financave, në bashkëpunim edhe me ekspertët e Universitetit të Harvardit, me Qendrën për Zhvillim Ndërkombëtar (CID), kanë hartuar dhe propozuar

projektligjin “Për korporatën e Investimeve Shqiptare”, i cili mundëson krijimin e Korporatës si dhe përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj.

Korporata e investimeve do të ketë kapacitetin për të transformuar ide dhe nisma investimesh në projekte të financueshme dhe tërheqjen e interesit nga investitorë cilësorë, duke përdorur më mirë dhe më me efektivitet e efikasitet, tokën dhe/ose asetet e tjera në pronësi të saj dhe të përgatisë projekte që nëse vlerësohen të përshtatshme, mund të financohen

Parimet mbi të cilat do të udhëhiqet si dhe funksionet e Korporatës së Investimeve

Korporata, është konceptuar dhe krijohet si shoqëri tregtare, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare, ku ministri përgjegjës për ekonominë do të jetë në cilësinë e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Korporatës. Projektligji gjithashtu parashikon mundësinë që aksione të Korporatës, të mund të zotërohen edhe nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare të Zhvillimit.

Në përmbushjen e funksioneve të saj, Korporata do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- përparësia e zhvillimit ekonomik në nivel qendror, vendor dhe rajonal, si dhe lidhjen me politikat shtetërore të zhvillimit;
- pavarësia në vendimmarrje, në kryerjen e funksioneve, në propozimin dhe zbatimin e projekteve;
- përfitueshmëria, fizibiliteti ekonomik dhe tregtar i projekteve;
- trajtimi në mënyrë të drejtë dhe të barabartë i palëve me të cilat bashkëpunon;
- ruajtjes dhe zhvillimit të vlerës së aseteve;
- dh. zbatimi me efektivitet, efikasitet, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave;
- nevojshmërinë dhe proporcionalitetin në marrjen e masave për realizimin e objektivave;
- respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, në procedura dhe treg, në përputhje me kuadrin ligjor mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore;
- zbatimi i procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme;
- integriteti dhe ndalimi i konfliktit të interesave në kryerjen e funksioneve dhe marrëdhëniet me partnerët dhe palët e treta;
- përgjegjësia ndaj palëve të interesuara dhe partnerëve;
- përgjegjësia për zhvillimin e politikave sociale.

Kjo strukturë nuk ekziston aktualisht në ekosistemin e agjencive në vend dhe as në sektorin privat. Korporata është konceptuar si një njësi me thelbin e një fondi investimesh, por me qëllim të përcaktuar për zhvillimin ekonomik të vendit, pra është konceptuar si një institucion që do të jetë në gjendje të përfaqësojë Qeverinë Shqiptare në menaxhimin e aseteve strategjike dhe në maksimizimin e mobilizimit të kapitalit privat, të marrë përsipër shfaqjen e riskut në projektet strategjike dhe gjithashtu të bashkëpunojë me institucione financiare ndërkombëtare (IFIs) dhe sektorin privat. Për të mobilizuar kapitalin, Korporata duhet të ketë kapacitetin për të strukturuar transaksione dhe të japë mbështetje financiare kur duhet për të reduktuar riskun tregtar.

Sa më sipër, në mënyrë më konkrete, disa nga funksionet kryesore të Korporatës të përcaktuara të propozuara në projektligj konsistojnë në:

- Zhvillimin dhe menaxhimin e pronave dhe projekteve në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
- Këshillimin e institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin, dhe rekomandimin e projekteve.
- Financimin ose bashkëfinancimin e projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e tyre.
- Dhe me autorizim të Këshillit të Ministrave marrjen e rolit të zhvilluesit sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik.”

Korporata do të ketë organet e saj si Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin mbikëqyrës, Drejtorin Ekzekutiv dhe Bordin Këshillimor, të cilët kanë detyrat e tyre të përcaktuara.

Efektet e funksionimit të Korporatës do të ndihen në krijimin dhe forcimin e hallkave ekonomike rreth projekteve të investimit që do të kryejë Korporata, rritjen e punësimit, transformimin e zonave ku do të bëhen investimet e Korporatës, lehtësimin për tërheqjen e investitorëve dhe shtimin e marrëdhënieve ndërmjet sektorit publik e privat.

Fusha e veprimtarisë dhe mjetet që i duhen Korporatës për të kryer funksionet e parashikuara kërkojnë përgatitjen e kuadrit ligjor specifik dhe për këtë qëllim ky projektligj do të pasohet edhe nga disa vendime të Këshillit të Ministrave, për të bërë të mundur rregullimin e plotë të veprimtarisë së Korporatës, në funksion të efektivitetit në përmbushjen e funksioneve dhe misionit të saj, pajtueshmërinë me sistemin ligjor dhe bashkëpunimin me institucione të tjera publike ose ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, bënë gjithashtu një prezantim përmbledhës mbi mënyrën e konceptimit të Korporatës si dhe dhanë shpjegime mbi pyetjet e shumta të bëra nga përfaqësuesit e opozitës dhe të mazhorancës në komision.

Në përfundim të shqyrtimit në parim të projektligjit, përfaqësuesit e opozitës, shprehën mos dakortsinë e tyre me projektligjin. Ato u shprehën se projektligji përbën një hap prapa për ekonominë dhe kthen modelet e vjetra e ta prapambetura si dhe nuk mbështetet në një model evropian. Krijimi i korporatës sipas opozitës, godet tregun e lirë, zgjeron influencat e qeverisë dhe pas PPP-ve është metoda e radhës për të influencuar. Nën petkun e investimeve shton mosbesimin dhe rrit ndjeshëm borxhin (kreditë). Korporata nuk e çliron tregun nga kthetrat e Qeverisë dhe nuk zgjidh problematikat.

Anëtarët e tjerë të mazhorancës, mbështeten nismën dhe iu bashkuan vlerësimit të detajuar të relatorit lidhur me rëndësinë dhe përfitimet që do të sjellë krijimi i kësaj Korporate dhe ndikimi ekonomik pozitiv që ajo vlerësohet se do të sjellë, duke theksuar se aludimet e përfaqësuesve të opozitës janë thjeshtë propaganda e radhës dhe nuk shprehin asnjë të vërtetë.

Pas diskutimit dhe miratimit në parim të projektligji, komisioni e shqyrtoi atë nen për nen.

Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, evidentoi faktin se projektligji ka kaluar në një fazë konsultimi me Komisionin Evropian, Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN-së) dhe Bankën Botërore, struktura këto që kanë dhënë rekomandimet e tyre lidhur me projektligjin.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sipërcituara, kanë rishikuar projektligjin dhe kanë bërë të mundur adresimin e të gjitha rekomandimeve, fakt ky i konfirmuar zyrtarisht nga Komisioni Evropian.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka ndjekur me kujdes komunikimet e mësipërme dhe duke vlerësuar dhe mirëpritur kontributin e Komisionit Evropian dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN-së) në përmirësimin e projektligjit, i cili mundëson krijimin e një kuadri ligjor të qëndrueshëm, të harmonizuar dhe bashkëkohor, e mori në shqyrtim projektligjin e përmirësuar (rishikuar) duke bërë edhe disa përmirësime të mëtejshme të tij.

Projektligji i rishikuar tashmë është konceptuar i ndarë në 5 krerë dhe 23 nene gjithsej dhe ndryshimet/përmirësimet e tij konsistojnë në sa më poshtë:

- Rishikimi i parimeve të përgjithshme mbi të cilat do të udhëhiqet korporata duke evidentuar përparësinë e zhvillimit ekonomik (dhe jo atij social) në nivel qëndror dhe rajonal si dhe lidhjen me politikat shtetërore të zhvillimit. Gjithashtu u përcaktua që respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, në procedura dhe treg do të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.
- Janë qartësuar burimet e financimit të Korporatës, duke përcaktuar si të tilla buxhetin e shtetit për kapitalizimin e saj (kapitalin fillestar), kontributin e institucioneve financiare ndërkombëtare, të ardhurat e përfituara nga aktivitet e saj dhe shërbimet e ofruara, nga donacionet në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe nga burime të tjera, të ligjshme. Gjithashtu është qartësuar ndarja e detyrimeve të Korporatës nga buxheti i shtetit, duke përcaktuar se çdo detyrim financiar që mund të lindi ndaj Korporatës nuk i transferohen buxhetit të shtetit dhe se kjo e fundit është përgjegjëse për shlyerjen e çdo detyrimi financiar. Këto ndryshime garantojnë mos cenimin e hapësirës fiskale, dhe harmonizimin me praktikën ndërkombëtare për distancën që duhet të kenë organizatat të tilla nga financat publike dhe qeveria.
- Janë riorganizuar dhe kombinuar dispozitat mbi funksionet dhe autorizimet e Korporatës duke lënë një nen të vetëm që liston funksionet kryesore të Korporatës, me qëllim thjeshtimin, qartësimin, dhe bërjen sa me koncize të roleve që do të kryejë Korporata. Gjithashtu, duke përmendur funksionet bazë, ky nen evidenton faktin se Korporata nuk ndërhyr në priorizimin që i bëhet projekteve të investimeve publike nga ministritë e linjës.
- Në trajtimin e mënyrës se si korporata do të mbështetet me infrastrukturë ndihmëse është shtuar përcaktimi se Korporata kontribuon proporcionalisht ose sipas mundësive në realizimin e infrastrukturës ndihmëse.

- Ndryshime ka pësuar edhe dispozita lidhur me marrjen e licencave/lejeve/autorizime, duke përcaktuar se, për marrjen e licencave/lejeve, pas dorëzimit të dokumentacionit nga Korporata, institucionet/entetet/autoritetet publike brenda 15 ditëve pune, kthejnë përgjigje mbi kërkesën për miratim të licencave/lejeve, sipas legjislacionit në fuqi. Përfundimisht, për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave/lejeve, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohore prej 30 ditë pune.
- Një qartësim më i plotë dhe unifikim edhe me legjislacionin nacional iu bë dispozitave lidhur me regjimin e prokurimeve, duke evidentuar qartë që procedurat përzgjedhëse do të nënshtrohen detyrimit konkurrimit dhe prokurimit. Kështu u përcaktua që për kontratat publike, të cilat financohen plotësisht nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, zbatohen rregullat e prokurimit që parashikohen nga kjo organizatë ose institucion. Në rastin e kontratave publike që bashke financohen në shumicën e tyre nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit. Për kontratat publike, të cilat financohen nga buxheti i shtetit zbatohen dispozitat e ligjit për prokurimin publik në fuqi.
- Përmirësime të ndjeshme kanë pësuar dispozitat lidhur me përbërjen e Këshillit Mbikqyrës së Korporatës, duke përcaktuar përbërjen e tij nga të paktën pesë anëtarë, shumica e të cilëve janë të pavarur. Kështu mundësohet garantimi i mos ndikimit të Korporatës nga Qeveria. Gjithashtu janë përcaktuar parimet mbi të cilat do të udhëhiqet funksionimi i këtij këshilli duke përcaktuar si të tilla parimin e mirëbesimit duke përfshirë detyrimin për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin, dhe pavarësinë në raport me Korporatën. Po ashtu janë përcaktuar edhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e këshillit mbikqyrës për tu përzgjedhur si të tillë.
- Pranë korporatës do të funksionojë gjithashtu edhe Bordi Këshillimor. Përmirësime kanë pësuar edhe dispozitat që përcaktojnë krijimin e këtij Bordi, funksioneve dhe mënyrës së krijimit të tij. Bordi Këshillimor, do të përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen nga Këshilli Mbikqyrës, tre prej të cilëve përfaqësojnë institucionet qendrore, dy përfaqësojnë institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe katër të tjerë janë të pavarur. Po ashtu janë përcaktuar edhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e Bordit për tu përzgjedhur si të tillë.
- Një përmirësim tjetër shumë i rëndësishëm lidhet me përcaktimin e autoriteteve që do të kryejnë auditimin e pasqyrave financiare të Korporatës, duke shtuar përcaktimin se kryerja e auditimit mbi përdorimin, administrimin e fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomikë dhe financiarë të shtetit do të kryhen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
- Për të mundësuar funksionimin e ligjit si dhe për të mundësuar krijimin e Korporatës, janë përcaktuar edhe dispozitat kalimtare përmes të cilave, ministri përgjegjës për ekonominë, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit do të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për të mundësuar sigurimin e kapitalit fillestar, zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Korporatës., miratimin e statutit të Korporatës si dhe regjistrimin e Korporatës pranë regjistrimit tregtar.

Gjatë shqyrtimit të gjithë ndryshimeve të përshkruara në mënyrë të përmbledhur më sipër, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhanë përgjigje dhe sqarime të detajuara ndaj pyetjeve të ngritura nga anëtarët e komisionit.

Për shkak të ndryshimeve të shumta të miratuara në komision, përkundrejt variantit të projektligjit të ardhur nga Këshilli i Ministrave dhe me qëllim mundësimin e evidentimit korrekt dhe më të kuptueshëm të tyre, u vlerësua me e drejtë që ndryshimet e miratuara të pasqyrohen në një variant integral.

VI. *Përfundime dhe ndryshimet e projekt aktit (nen për nen)*

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të ndikojë pozitivisht në përshpejtimin e rritjes ekonomike, përmes zgjerimit të kapacitetit të ekonomisë, për të identifikuar, përgatitur dhe ekzekutuar, projekte investimi me impakt të gjerë, që kërkojnë shfrytëzimin e aseteve shtetërore si dhe mobilizimin e kapitalit privat, me votat pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi sipas tekstit integral bashkangjitur dhe pjesë të këtij raporti.

RELATOR

Reme LALA

KRYETAR

Arben AHMETAJ